



Pranuar / Dorezuar Punëues/Prodator Received/Delivry	04.11.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	6742	2022	119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.811/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.811/2022 të datës 21.09.2022, të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi rrugë [redacted]

[redacted] kundër Vendimit me numër KA.Nr.27/2022 të datës 24.08.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i iniciuar me ankesën me numër A.nr.811/2022 të datës 21.09.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] ka aplikuar në konkursin e datës 15.06.2022 i shpallur në Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me numër reference KPK/SKPS/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-10, për dy(2) pozita: *Bashkëpunëtor Profesional*, në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, i hapur deri me datës 29.06.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila ka marre pjese ne te gjitha fazat e rekrutimit gjegjesisht ankuesja është përfshirë në listën e shkurte, testin me shkrim të datë 13.07.2022 dhe intervistës me goje.

Me datë 25.07.2022 Divizioni i Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka publikuar njoftimin lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të dy kandidatëve të suksesshme per dy (2) pozita për "*Bashkëpunëtor profesional*" në Prokurorin Themelore në Mitrovicë, ndërsa ankuesja nuk është listuar si kandidat e përzgjedhur.

Ankuesja kundër njoftimit të datës 25.07.2022 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të dy kandidatëve të suksesshëm për dy (2) pozita për "*Bashkëpunëtor profesional*" në Prokurorin Themelore në Mitrovicë me datë 11.08.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datë 24.08.2022 ka nxjerrë Vendim me numër KA.Nr.27/2022 me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën të datës 11.08.2022 të parashtruar nga ankuesja dhe ka lënë në fuqi Njoftimin e datës 25.07.2022 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, për pranimin e kandidatëve me të suksesshëm për pozitë: "*Bashkëpunëtor profesional*", në Prokurorin Themelore në Mitrovicë, me numër të referencës KPK/SKPS/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-10.

Ankuesja kundër Vendimit KA.Nr.27/2022 të datës 24.08.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë me datë 19.09.2022 përmes Postës së Kosovës e cila është pranuar në Këshill me datë 21.09.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të aplikimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të dispozitave materiale dhe shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, gjegjësisht ankuesja pretendon se proceduara e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.09.2022 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 12.08.2022 me numër protokollit 6113/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:5542/2022 të datës 21.09.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës së Kosovës me numër R2429957; Vendimi KA.Nr.27/2022 i datës 24.08.2022 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesa e datës 02.08.2022 drejtuar tek Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës; Pliko/zarfë nga posta e Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 12.10.2022 e protokolluar me nr.6113/2022 në KPMSHCK-së; Aplikacioni i datës 29.06.2022 znj. K.I. ; Diplomë e datës 02.12.2015 nr. 3709 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "*Hasan Prishtina*"; Certifikatë e datës 29.12.2017 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, për provimin e dhënë të Jurisprudencës; Certifikatë e datës 16.11.2015-praktik Gjyqësore - lëshuar nga Këshillin Gjyqësor i Kosovës; Kontratë e punës për kohë të pacaktuar e datës 01.10.2018, lëshuar nga Noteri z. K.M; Kontratë e punës për kohë të pacaktuar e datës 01.10.2010, lëshuar nga Zyra e Avokatit në Mitrovicë z. XH.H; Referencë e datës 02.04.2022; Letër rekomanduese e datës 25.01.2016; Vërtetim për përformacë të punës nga data 01.10.2018 deri me datë 31.10.2020; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Drejtësi e datës 30.03.2012, për ndjekjen e punës praktike, Certifikatë e datë 19.05.2012 e Gjuhës Angleze - niveli mesimor B2- e lëshuar nga Qendra e Gjuhëve të huaja "*Viktoria School*"; Certifikatë e datë 08.12.2012 e Gjuhës Angleze-niveli mesimor B2 - e lëshuar nga Qendra e Gjuhëve



të huaja "Viktoria School"; Pasqyra e trustit e lëshuar me datës 24.06.2022; Certifikatë e Shtetësisë e datës 29.06.2022; Certifikatë e evidencës penale e lëshuar me datës 29.06.2022 nga Gjykata Themelore në Mitrovicë; letërnjoftimi dhe pliko/zarfë e datës 29.06.2022 me nr. R2352544; Konkursi i datë 15.06.2022 deri me 29.06.2022 i shpallur për pozitë: bashkëpunëtor profesionalë; Vendimi DPSKPK/NR.298/2022 i datës 04.07.2022 për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Miratim i deklaratës së datës 04.07.2022 me numër reference DPSKPK/300/2022; Deklaratë e datës 04.07.2022 me numër reference DBNJ/NR.192/2022; Aplikacioni i znj. E.S.XH e datës 23.06.2022; Diplomë e datës 30.11.2016 Nr.4373, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në Prishtinë; Certifikatë e notave e datës 19.03.2019 nga niveli Master, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në Prishtinë; Certifikatë e datës 15.04.2019 Nr.49/2019 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, për provimin e dhënë të Jurisprudencës; Certifikatë e datës 15.01.2018 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, praktikë gjyqësore; Kontratë e punës për kohë të pacaktuar e datës 01.12.2018, lëshuar nga NPSH -Kompania ALHA në Mitrovicë, në pozitë zyrtare ligjore; Shkëputje e kontratës së punës me datës 28.02.2020, lëshuar nga NPSH -Kompania ALHA në Mitrovicë, me raport të vlerësimit të punës te datës 31.12.2019; Rekomandim nga Gjyqtari z. S.SH. i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- mars 2018; Rekomandim nga NPSH -Kompania ALHA në Mitrovicë; Certifikatë e evidencës penale e lëshuar me datës 23.06.2022 nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Letërnjoftim; Aplikacioni ankuseses i datës 21.06.2022 përmes postës me numër R 2278944; Diplomë e datës 10.07.2014 Nr.2609, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në Prishtinë; Certifikatë e datës 23.12.2019 Nr.380/2019, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, për provimin e dhënë të Jurisprudencës; Vërtetim i datës 10.03.2021, lëshuar nga i Mitrovicë; Certifikatë e datës 05.01.2017 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë- për praktikë gjyqësore; Formular të vlerësimit të punës-praktik vullnetare pa pagesë; Certifikatë e datës 18.09.2018 lëshuar nga IKT-së; Pasqyra e Trustit i nxjerrë me datës 03.12.2021; Certifikatë e evidencës penale e lëshuar me datës 02.12.2021 nga Gjykata Themelore në Mitrovicë; Njoftimi i datës 06.07.2022 i kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë; Deklaratë e datës 13.07.2022 për mos ekzistimin e konfliktit të interesit; kopje -testi me shkrim i datë 13.07.2022 i ankuseses znj.A.D; Deklaratë e datës 13.07.2022 për mos ekzistimin e konfliktit të interesit; kopje -testi me shkrim i datë 13.07.2022 i znj. E.XH; Deklaratë e datës 13.07.2022 për mos ekzistimin e konfliktit të interesit; kopje -testi me shkrim i datë 13.07.2022 i znj. K.I; Forma tabelore e vlerësimit të testit me shkrim nga pesë (5) anëtarët e Komisioni i Rekrutimit; Çelësi i testit me shkrim i datës 13.07.2022; Përmbledhja e vlerësimit individuale e intervistës, i datës 19.07.2022; Përmbledhja e vlerësimit individualë e intervistës, e testit me shkrim dhe intervistës (%) përqindje, i datës 19.07.2022; Raporti i rekrutimit nga Komisioni i Rekrutimit i datës 18.07.2022 ; Njoftimin i datës 25.07.2022 për përzgjedhjen përfundimtare; Njoftim i datës 03.11.2022 nga ankuesja, përmes Postes së Kosovës të datës me numër R2434477 e protokolluar me numër 6670/2022, për KPMSHCK-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ e filluar me ankesën me numër A.nr.811/2022 të datës 21.09.2022 e parashtruar nga ankuesja sepse:

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, konstaton se ankuesja me datë 21.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1874/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 03.11.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokoll



6670/2022 për tërheqje të ankesës me numër Anr.811/2022 të protokolluar me numër 1874/2022 të datës 21.09.2022, me arsyetimin se: „ Me datë 19.09.2022 kam ushtruar ankesë kundër Vendimit KA.Nr.27/2022 të datës 24.08.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për konkursin e shpallur me datën 15.06.2022 për pozitën „Bashkëpunëtor Profesional“ në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë. Shpresoj që lënda nuk është vendosur dhe dëshiroj që ankesën time ta Tërhjeku për disa arsye personale.

Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *“Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, andaj duke u nisur nga veprimi administrativ i ankueses për tërheqjen e ankesës së parashtruar në Këshill, Kolegji konstaton që të përfundojë procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.811/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.811/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.